

VENDIM
Nr. 823, datë 7.10.2015

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE
NDËRTIMORE NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet maksimale, për të cilat miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën e ndërtimit pa leje, të jenë sipas listës emërore dhe evidencës që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Numri i parcelave ndërtimore dhe sipërfaqja e përgjithshme e truallit për secilin qark janë, si më poshtë vijon:

a) Qarku Fier, 70 (shtatëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 21 219 (njëzet e një mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) m²;

b) Qarku Tiranë, 78 (shtatëdhjetë e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 17 762 (shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) m²;

c) Qarku Vlorë, 45 (dyzet e pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 12 574 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) m²;

ç) Qarku Gjirokastrë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 597 (pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) m²;

d) Qarku Dibër, 38 (tridhjetë e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 744 (nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër) m²;

dh) Qarku Shkodër, 72 (shtatëdhjetë e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 16 637 (gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) m²;

e) Qarku Elbasan, 25 (njëzet e pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 7 474 (shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) m²;

ë) Qarku Berat, 4 (katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 300 (një mijë e treqind) m²;

f) Qarku Korçë, 23 (njëzet e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 886 (dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) m²;

g) Qarku Lezhë, 38 (tridhjetë e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 518 (nëntë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) m²;

gj) Qarku Durrës, 28 (njëzet e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 684 (nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër) m²;

h) Qarku Kukës, 48 (dyzet e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 13 985 (trembëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) m².

3. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesit e ndërtimeve pa leje.

4. Deri në momentin e regjistrimit të ndërtimit të legalizuar, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të mos kryejnë ndryshime të gjendjes juridike të pasurive të listuara në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama